KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Gusht 2023

25.09.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin gusht 2023.

Rritet numri përfituese nga skema e pensioneve bazike të moshës në gusht 2023, krahasuar me gusht 2022

Në muajin gusht 2023 nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 20 810 familje me gjithsej 81 903 anëtarë, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që ishte 24 627 familje me gjithsej 97 124 anëtarë, vërehet një rënie e numrit të familjeve përfituese nga kjo skemë për 3 817, ose 15,5%.

Numri i përfituesve nga skema e ndihmës sociale



Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin gusht 2023, krahasuar me muajin gusht 2022 kishte rritje të përfituesve nga: Skema e pensioneve bazike të moshës (18,1%); skema për pensionet e personave paraplegjik dhe tetraplegjik (16,1%); skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara

(14,7%); skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) (10,7%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (7,1%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (5,6%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,3%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (2,8%); skema për veteranët e luftës (0,2%).

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin gusht 2023, krahasuar me muajin gusht 2022, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet e Trepçës (-18,6%); skema për pensionet invalidore (-18,0%); skema për pensionet familjare (-9,6%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,6%); skema e kompensimeve për personat e verbër (-0,2%).

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

Përfituesit e pensioneve dhe skemave tjera sociale	Muaji/Viti		08.2023 / 08.2022
	08.2022	08.2023	
Pensionet bazike të moshës	125 515	148 180	18,1
Pensionet kontributpaguese të moshës	45 462	48 020	5,6
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	19 034	20 381	7,1
Pensionet e Trepçës	1 820	1 482	-18,6
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	673	745	10,7
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1 265	1 301	2,8
Skema e të verbërve	1 848	1 844	-0,2
Pensionet Familjare	3 318	2 999	-9,6
Pensionet e Invalidëve të punës	61	50	-18,0
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	2 497	2 900	16,1
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	12 686	13 364	5,3
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	13 152	12 944	-1,6
Veteranët	36 761	36 852	0,2
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	2 794	3 205	14,7

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin gusht 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare